



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 509/prot.  
53

Tiranë, më 27.12.2022

**VENDIM**  
Nr. 946, Datë 27.12.2022

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË VENDIMIT NR. 822, DATË 02.09.2021 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË MASKAVE, NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË ALKOOLEVE DHE GELDEZINFEKTUES, NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË TERMOMETRAVE DHE DHËNIEN E DISA DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES CFO PHARMA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbyllja e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 822, datë 02.09.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK”.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe neni 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimit nr. 822, datë 02.09.2021.

**VËREN SE:**

1. Komisioni i Konkurrencës në përfundim të procedurave të hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 43, pika (5) dhe nenin 45, pika (2) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e

konkurrencës”, me vendimin nr. 822, datë 02.09.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK”, vendosi:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
  - II. Detyrimin e ndërmarrjes CFO Pharma SHPK të mos bëjë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:
    - a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
    - b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
    - c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
    - d. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
    - e. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
  - III. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja CFO Pharma SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
  - IV. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes CFO Pharma SHPK për një periudhë 12 mujore nga marrja e vendimit.
2. AK në kuadër të monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të VKK nr. 822, datë 02.09.2021, ka bashkëpunuar me ndërmarrjen CFO Pharma SHPK duke administruar informacionin, si më poshtë vijon:
- AK me shkresën nr. 509/7 prot., datë 01.08.2022 dhe nr. 509/18 prot., datë 31.08.2022 “Kërkesë për informacion” drejtuar ndërmarrjes CFO Pharma SHPK ka kërkuar informacion mbi blerjet dhe shitjet analitike për produktet maska, xhel desinfektant, alkool dhe termometra infrared për periudhën 02 shtator 2021 – 31 korrik 2022.
  - Ndërmarrja CFO Pharma SHPK me shkresën nr. 509/38 prot., datë 06.09.2022, ka informuar në lidhje me zbatimin kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në VKK nr. 822/2021.
3. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen CFO Pharma SHPK, konstatohet se kjo ndërmarrje për periudhën e monitorimit ka treguar vetëm produktin maska.
- i. Lidhur me analizën e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të maskave**
4. Produkti maska është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë. Referuar të dhënave

teknike dhe cilësore të tyre, maskat janë ndarë në katër kategori: maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3, maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95), maskë kirurgjikale e thjeshtë dhe maskë prej pëlhure.

5. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes CFO Pharma SHPK, grupi i punës i ka analizuar produktet të klasifikuar Maskë të ndara sipas kategorive: Maskë Kirurgjikale; Maskë KN95 me Valvul; Maskë KN95 pa Valvul; Maskë FFP2 pa Valvul dhe Maska për fëmijë.
6. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 ka treguar vetëm produktin Maskë Kirurgjikale të shitur me një sasi prej 468 200 copë.
7. Në fund të analizës për kategorinë e produktit Maskë është konstatuar se ndërmarrja CFO Pharma SHPK ka aplikuar çmime mesatare të shitjes të ndryshme nga çmimet që kanë aplikuar ndërmarrjet e tjera përgjatë periudhës së monitorimit dhe për pasojë nuk ka shkelje në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

**ii. Lidhur me analizën e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel dezinfektues**

**ii.1 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve**

8. Produkti alkool është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, alkooli ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të gradës dhe sasisë në paketim.
9. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 nuk ka tregtuar produktin alkool.

**ii.2 Analiza e tregut të importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues**

10. Produkti gel dezinfektues është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19. Referuar të dhënave teknike, produkti gel dezinfektues ndahet në disa lloje të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në bazë të sasisë së paketuar.
11. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 nuk ka tregtuar produktin gel dezinfektues.

**iii. Lidhur me analizën e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave**

12. Produkti termometër infrared është një nga produktet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë.

13. Ndërmarrja CFO Pharma SHPK, përgjatë periudhës së monitorimit 2 shtator 2021 – 31 korrik 2022 nuk ka tregtuar produktin termometër.
14. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjes CFO Pharma SHPK në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkoolit; në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të gel dezinfektues dhe në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometër nuk konstatohet ekzistenca e një sjelljeje të bashkërenduar e cila bie në kundërshtim me nenin 3, pika 4, nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
15. Për sa më sipër, kushtet dhe detyrimet të dhëna në pikën II të dispozitivit të vendimit nr. 822, datë 02.09.2021, janë zbatuar nga ndërmarrja CFO Pharma SHPK.

#### PËR KËTO ARSYE:


Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


#### VENDOSI:


- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të vendimit nr. 822, datë 02.09.2021 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe geldezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave dhe dhënien e disa detyrimeve ndaj ndërmarrjes CFO Pharma SHPK”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Leida MATJA**  
  
 Zv/Kryetar

**Rezana KONOMI**  
  
 Anëtar

**Adriana BERBERI**  
  
 Anëtar

**Durim KRAJA**  
  
 Anëtar

**Denar BIBA**  
  
 Kryetar